



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 1357 prot.

Gjirokastrë, më 16.09. 2025

APROVOI
REKTORI

Prof. dr. Jaho Çauja



Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Universitetin Daugavpils, Letoni.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti Daugavpils hap thirrjen për shkëmbim studentësh me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes Ndërinstitucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me 2 (dy) studentë, për periudhën shkurt - qershor 2025. Thirrja është e hapur për studentët e ciklit të parë të studimit (Bachelor) dhe ciklit të dytë (Master) të Njesisë Bazë të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Njesisë Bazë të Gjuhëve të huaja dhe Njësive Bazë të Fakultetit Ekonomik. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht B2.

Të interesuarit të dërgojnë pranë Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **30.09.2025**, në formë fizike dhe elektronike:

- Vërtetim studenti;
- Listë notash;
- Letër Interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS në anglisht;
- Provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze ose spanjolle në nivelin B2;
- Fotokopje të pasaportës dhe kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision *ad hoc* i ngritur pranë UGJ-së dhe më pas, Sektori i Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor do t'i përcjellë nominimet universitetit partner për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Zv/Rektore për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj